



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 221, datë 22.10.2019

**PËR
VLERËSIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR ZNJ. {...}, KRYEINPEKTORE
E ISH-KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 283, të ligjit nr. 115/2016, “*Për Organet e Qeverisjes Vendore së Sistemit të Drejtësisë*” dhe në nenin 168, të ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, pasi shqyrtoi Raportin e Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ngritur me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019, të këtij Këshilli, lidhur me Kryeinspektoren {...}, në përfundim,

VËREN

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019 ngriti Komisionin e Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili kishte për detyra të evidentojë:

- a) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve;
- b) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve;
- c) inspektorët të cilët gëzojnë statusin e magjistratit dhe cilët ndër inspektorë nuk e gëzojnë këtë status.
- d) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit;
- e) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet;
- f) dhënia e pëlqimit nga secili inspektorë për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të këtyre detyrave Komisioni i Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë verifikoi dhe konstatoi se:

Kryeinspektore {...}, ka lindur në Berat me datë 06.03.1975. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1993-1997. Më pas ajo ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës në vitet akademike 1997-2000.

Pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me Dekretin nr. 2756, datë 27.09.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri kur me vendimin nr. 219, datë 17.12.2007, të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë largohet nga sistemi gjyqësor me kërkesën e saj, për të shërbyer në nivele drejtuese në Ministrinë e Drejtësisë, ku në dhjetor të vitit 2007, filloi punë si këshilltare në kabinetin e Ministrisë të Drejtësisë, deri në shtator 2008, ku më pas u emërua Drejtoreshë e Përgjithshme (e Kodifikimit dhe Çështjeve të Drejtësisë) në Ministrinë e Drejtësisë, deri në vitin 2013.

Duke u bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 303, datë 18.01.2013, ka emëruar znj. {...} në detyrën e Kryeinspektores të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, detyrë të cilën e kryen edhe aktualisht.

Për Kryeinspektoren {...}, institucion tjetër kushtetues, siç është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtarë të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dhënë vendimin nr. 115, datë 11.03.2019, ku shpreh ndërmjet të tjera se, subjekti i rivlerësimit e ka humbur statusin e magjistratit, duke ndërprerë kështu procesin e rivlerësimit për znj. {...}. Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë, pasi kundër këtij vendimi subjekti i rivlerësimit znj. {...}, ka depozituar kërkesën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Bazuar në Kreun VII, Çështjet Paraprake dhe Vendimet e Ndërmjetme, Neni 66, i Kodit të Procedurës Adinistrative,

“1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”, si dhe gjithashtu duke u bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, Juridiksioni, të Kodit të Procedurës Civile “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata....”

Për sa më sipër, dhe ndodhur përpara faktit që në rastin e Kryeinspektores znj. {...}, pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk ka një vendim përfundimtar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, institucion i cili ka aktualisht çështjen në shqyrtim, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund të shprehet me një vendim përfundimtar për vlerësimin e statusit individual të znj. {...}.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nenin 283 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenin 168 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtarë të

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, nenit 66, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar dhe nenit 36, “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Të pezullojë vlerësimin mbi statusin individual të znj. {...}, Kryeinspektore pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, deri në vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbi ankimin e regjistruar me nr. 29/2019, datë 30.05.2019 kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 115, datë 11.03.2019.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR